



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT VJETOR – 2017**

Drejtoria	Drejtoria e kadastrit në Prishtinë
Periudha raportuese	<b>Raporti vjetor – viti 2017</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Nora Kelmendi, Drejtore e drejtorisë së kadastrit

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues**

Drejtoria e kadastrit - Zyra kadastrale komunale (ZKK) e Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa me efikase për qytetar duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhuruara për pronat e paluajtshme.

Gjatë vitit 2017 në 6 zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **40,441** kërkesa nga të cilat janë aprovuar **39,380** kërkesa, janë refuzuar **173** dhe kanë mbetur në procedurë edhe **99** kërkesa të cilat janë realizuar përmes 2 sektorëve: sektorit të kadastrit dhe sektorit të gjeodezisë.

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj .**

Aktivitetet e planifikuara të drejtorisë së kadastrit janë:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastral
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënie e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. **AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

Në Drejtorinë e kadastrit në Prishtinë gjatë vitit 2017 nëpërmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve atij të kadastrit dhe gjeodezisë janë pranuar kërkesa të ndryshme prej të cilave:

**I. Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 3,665 kërkesa për regjistrim të pronësisë prej të cilave janë aprovuar 2748, janë refuzuar 134 kërkesa, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me 68 konkluzione duke e pezulluar procedurën deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse.
- 206 kërkesa për historiate nga persona fizik, institucione prej të cilave janë aprovuar 176 dhe 7 kanë mbetur në procedurë.
- 2,647 shkresa / kërkesa, nga institucionet e ndryshme prej të cilave janë realizuar të gjitha.
- 505 kërkesa për përmirësime në RDPP prej të cilave të aprovuara 391, të refuzuara 26 dhe në procedurë kanë ngelur edhe 8 kërkesa.
- 19 kërkesa për regjistrim dhe çregjistrim të barrave tatimore të aprovuara në tërësi
- 835 kërkesa për regjistrim të hipotekave, të aprovuara si dhe 558 kërkesa për çregjistrim nga të cilat janë aprovuar 547, janë refuzuar 3 dhe 2 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

**Totali i kërkesave të pranuar për sektorin e kadastrit ka qenë: 8,434 nga të cilat 7,363 kërkesa janë aprovuar, 163 janë refuzuar dhe 85 kërkesa kanë ngelur në procedurë.**

**II. Në sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:**

- 27,661 kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kopje të planit, të realizuara të gjitha.
- 206 kërkesa për ndarje të pronësisë nga të cilat janë aprovuar 198 kërkesa, është refuzuar 1 kërkesë dhe në procedurë kanë mbetur edhe 3 kërkesa.
- 116 kërkesa për bashkim të parcelave nga të cilat janë aprovuar 110, janë refuzuar 2 dhe 4 kanë ngelur në procedurë.
- 56 kërkesa për inçizim të ndërtesave nga të cilat 49 janë aprovuar, 1 është refuzuar dhe 6 kërkesa kanë ngelur në procedurë.
- 556 kërkesa për dhënien e produkteve (koordinatave) - të aprovuara dhe realizuara të gjitha.
- 690 kërkesa për identifikimin e parcelave dhe njësisve banesore nga të cilat janë aprovuar 730 ( 35 nga muajt e kaluar) ndërsa në procedurë kanë mbetur edhe 5 kërkesa.
- 151 kërkesa për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri nga të cilat 145 janë aprovuar, 3 janë refuzuar dhe 3 kanë ngelur në procedurë.
- 27 kërkesa për ndërrim kulture nga të cilat janë aprovuar 27, 1 lëndë është refuzuar dhe në procedurë ka mbetur edhe 1 lëndë ( nga muajt e kaluar).
- 14 kërkesa si plotësim pagese janë realizuar të gjitha.
- 747 kërkesa nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara nga të cilat janë aprovuar 740 nga të cilat 1 është refuzuar dhe 6 kërkesa kanë mbetur në procedurë.

- 239 kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet Drejtoritë e Komunës së Prishtinës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., nga të cilat janë aprovuar 236, 1 është refuzuar dhe të tjerat kanë ngelur në procedurë.
- 1,543 kërkesa të tjera për përmirësime, ankesa, plotësim lënde etj, të cilat janë aprovuar të gjitha.

**Totali i kërkesave të pranuar për sektorin e gjeodezisë ka qenë: 32,006 kërkesa, nga të cilat 32,020 (disa nga muajt e kaluar) janë aprovuar, 10 janë refuzuar dhe 20 kërkesa kanë ngelur në procedurë të shqyrtimit.**

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se drejtoria e kadastrit ka realizuar më shumë se 90 përqind të planit të saj duke i aprovuar, refuzuar, dhe pezulluar kërkesat e palëve në procedurë sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa. E arritur e kësaj Drejtorie është që në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve ka arritur të nxjerr vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palë/subjektet fizike dhe juridike.

#### **4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.***

Nga sektori i kadastrit aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së pa luajtshme në operatin kadastral.
- Lëndët e dërguara në KPA verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, arkivi komunal ose ndër komunal.

Nga sektori i gjeodezisë aktivitetet të cilat janë në implementim e sipër janë:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave.
- Lëndët për identifikimin e njësisve banesore.
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

**4.1.1. STATISTIKAT-Të listohen te gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës. pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.**

<b>Kërkesat e pranuar në drejtorinë e kadastrit për vitin 2017</b>	<b>Numri total i kërkesave</b>	<b>Të aprovuara</b>	<b>Të refuzuara</b>	<b>Në procedurë</b>	<b>Mjetet e grumbulluara €</b>
Çertifikata të pronësisë & Kopje të planit	<b>27,661</b>	<b>27,661</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>131,463</b>
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	<b>3,665</b>	<b>2,748</b>	<b>134</b>	<b>68</b>	<b>135,527</b>
Kërkesa për historiate zyrtare, historiate për persona fizik dhe juridik	<b>206</b>	<b>176</b>	<b>0</b>	<b>7</b>	<b>2,190</b>
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe Institucione të tjera - Shërbimi i RDPP-së	<b>2,647</b>	<b>2,647</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,756</b>
Përmirësime në RDPP	<b>505</b>	<b>391</b>	<b>26</b>	<b>8</b>	<b>10,120</b>
Regjistrime dhe çregjistrime të barrës tatimore	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>300</b>
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	<b>835</b>	<b>835</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>83,780</b>
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	<b>558</b>	<b>547</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>5,580</b>
Ndarjet - parcelizimet / copëtimet	<b>206</b>	<b>198</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>20,377</b>
Inçizimi i ndërtesave	<b>56</b>	<b>49</b>	<b>1</b>	<b>5</b>	
Bashkimi i parcelave	<b>116</b>	<b>110</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>8,798</b>
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale ( koordinatave)	<b>556</b>	<b>567</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>14,495</b>
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	<b>690</b>	<b>730</b>	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>15,380</b>
Përcaktimi dhe ri-rregullimi i kufirit të parcelave	<b>151</b>	<b>145</b>	<b>3</b>	<b>0</b>	<b>6,665</b>
Ndërrim i kulturës	<b>27</b>	<b>27</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>23,960</b>
Plotësim pagese	<b>14</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	
Kërkesat me licencë	<b>747</b>	<b>740</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>56,908</b>
Kërkesa zyrtare nga institucionet - Shërbimi i gjeodezisë	<b>239</b>	<b>236</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>789</b>
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësim lënde etj.	<b>1,543</b>	<b>1,543</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,577</b>
<b>Totali</b>	<b>40,441</b>	<b>39,383</b>	<b>173</b>	<b>105</b>	<b>519,665</b>

#### **4.1.1. Buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese**

Drejtoria e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastral përkundrazi kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

#### **4.1.2. Takimet me palë**

1. **Spektori i kadastrit** - gjegjësisht zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP) ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (**e martë, e enjte**) nga **2 orë në ditë** me dy zyrtar ligjor ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palës. Zyrtarët e zyrës për RDPP takohen orientimisht gjatë vitit me mbi **4,000** qytetar.
2. **Spektori i gjeodezisë** - ka takime të rregullta me palë **një herë në javë (të mërkurën)** ku gjatë vitit 2017 kemi pranuar mbi **3,000** palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu kemi takime me palë për identifikimin e banesave si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

#### **5. Takimet me institucione të tjera**

- **Spektori i kadastrit** - Takim me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale pronësore për të cilat kemi gjetur zgjidhje ligjore ose i kemi udhëzuar palët që t'i drejtohen institucioneve tjera në vend. Takimet bëhen në baza ditore si dhe çdo të marte dhe të enjte nga ora 10:00 - 12:00 paradite.
- Gjithashtu ka pasur takime me përfaqësues të institucioneve tjera si: AKP, NPB, Policia e Kosovës, Prokurorë, përfaqësues të ATK-së, përfaqësues të Bankës Botërore, përfaqësues të AKK-së, përfaqësues të Avokatit të Popullit, përfaqësues të KFOR-it Italian, përfaqësues të shoqërisë civile (OJQ dhe gazetarë), etj.

#### **6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë**

Nuk kemi pas asnjë diskutim publik.

##### **6.1.1. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

Në Drejtorinë e Kadastrit ka pasur kërkesa për qasje në dokumente zyrtare dhe të njëjtit i kanë marr përgjigjet konform ligjit në fuqi për qasje në dokumente zyrtare.

##### **6.1.2. Lëndët e pranuar, kryera dhe në përfundim e sipër**

- Spektori i kadastrit:
  - Lëndë të pranuar - **8,435**
  - Lëndë të aprovuara - **7,363**
  - Lëndë të refuzuara - **163**
  - Lëndë në procedurë - **85**

- Sektori i gjeodezisë:
  - Lëndë të pranuar - **32,006**
  - Lëndë të aprovuara - **32,020**
  - Lëndë të refuzuara - **10**
  - Lëndë në procedurë - **20**

#### 7. *Takime të tjera*

Në drejtori kemi pas edhe takime të tjera me palë të cilat takime janë bërë me palë të ndryshme nga drejtoria dhe 2 udhëheqëset e sektorit. Gjithsej kemi pranuar mbi 7,500 palë në takime për çështje të ndryshme pronësore nga të cilat takime palët kanë marr rekomandime dhe sugjerime varësisht nga natyra e problemit.

8. ***SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.***

#### **Sektor i kadastrit:**

- Sfiduese është komunikimi me institucionet, mos përgjigjet e tyre në afate ligjore të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.  
5 kërkesa presin për - Verifikime ne Arkiv Komunal dhe Ndër komunal  
101 kërkesa presin për Verifikime ne Gjykate  
6 kërkesa persin për Verifikime ne Privatizim  
13 kërkesa presin për Verifikime ne NPB  
22 kërkesa presin për Verifikime ne KPA  
3 kërkesa presin për Verifikime ne Drejtorinë për Financa dhe Prone
- Mungesa e stafit profesional gjegjësisht udhëheqësit të sektorit të kadastrit gjegjësisht shërbimit për RDPP, e që në situata të ndryshme do të ndihmonte Zyrën për RDPP në regjistrimin e të drejtave pronësore në regjistrat kadastral.

#### **Sektor i gjeodezisë:**

- Sfiduese është komunikimi me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, mos përgjigjet e tyre në lidhje me problemet që hasim çdo ditë me programin CadastralMap dhe SITK të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve.
- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike, gabimet të cilat janë krijuar me rastin e rikonstruimit të disa zonave kadastrarle nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

9. ***REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.***

#### **Sektor i kadastrit:**

- Trajnime për zyrarë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj
- Furnizim me dollapë për arkivim të lëndëve të pezulluara dhe refuzuara.
- Furnizim me një skaner i cili do të na ndihmonte në mbarëvajtjen e punës.

**Sektori i gjeodezisë:**

- Trajnime për zyrtar sa i përket aplikimit të Kornizës së punës
- Furnizim me printer me ngjyra
- Furnizim me një skaner i cili do të na ndihmonte në mbarëvajtjen e punës

**10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES -Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues***

**Sektori i kadastrit:**

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë punë.
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave.
- Lëndët për verifikim në NPB, Gjykatë, Arkiv Komunal ose Ndër komunal.

**Sektori i gjeodezisë:**

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave)
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri rregullim kufiri
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetët apo kompanitë e licencuara
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

**11. *TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme***